



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMIT TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 196 / Prot
4

Tiranë, më 01/07 /2025

V E N D I M
Nr. 6, datë 25/06/2025
PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLIT SHKENCOR

Në mbështetje të Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri*" i ndryshuar, të nenit 11, gërma "e" dhe "*Kodit të procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë*", Kreut I "*Akti Administrativ*" dhe të Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*" në përfundim të mbledhjes Bordi ,

V E N D O S I

1. Zgjedhjen e 6 anëtarve të Këshillit Shkencor të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri si më poshtë.
 - Ardian Muhaj
 - Edlir Orhani
 - Enriketa Pandlejmoni
 - Gentiana Kera
 - Ines Stasa
 - Vehap Kola
2. Marrdhëniet financiare janë në vazhdimësi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Mentor Beqa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMIT TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 196/Prot
5

Tiranë, më 01/07/2025

V E N D I M

Nr. 6/1, datë 25/06/2025

MBI ANKIMIMIN E Z.AGIM BAÇI

Bordi administroi ankimin e paraqitur nga z. Agim Baçi, një nga kandidatët për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizimit (ISKK), në lidhje me zgjedhjen e z. Çelo Hoxha si Drejtor Ekzekutiv të ISKK-së bazuar në Vendimin e Bordit të ISKK-së Nr.5, datë 03.06.2025, të paraqitur nëpërmjet ankesës së protokolluar me Nr. 186 Prot, datë 05.06.2025, të cilin e çmoi si të pranueshëm për t'u shqyrtuar duke qenë se është paraqitur brenda afatit kohor, si dhe në formën e përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Bordi i ISKK-së:

- pasi mori në shqyrtim pretendimet e ngritura nga z. Agim Baçi në ankimin e tij të paraqitur nëpërmjet ankesës së protokolluar me Nr. 186 Prot., datë 05.06.2025, të cilat u konfirmuan nga ana e z. Agim Baçi edhe gjatë seancës për shqyrtimin e ankimit;
- pasi dëgjoi shpjegimet e z. Çelo Hoxha në lidhje me pretendimet e ngritura nga z. Agim Baçi, të cilat u paraqitën edhe në formë shkresore nga ana e z. Çelo Hoxha nëpërmjet shkresës së protokolluar me Nr. 196/2 Prot, datë 25.06.2025;
- pasi dëgjoi shpjegimet e znj. Zoica Graçi në cilësinë e drejtueses së njësisë përgjegjëse pranë ISKK-së;

bazuar në përcaktimet e nenit 136 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të germës f) së pikës 1 së nenit 11 të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizimit në Shqipëri*", i ndryshuar, si dhe të nenit 8 të Rregullores "*Për funksionimin e Bordit të ISKK-së*",

Adresa : Rruga e Saraçevë, "Selvia"; web:www.iskk.gov.al, e-mail:info@iskk.gov.al

VENDOSI

1. Me shumicë votash, që pretendimet e ngritura nga z. Agim Baçi në ankimin e tij të paraqitur nëpërmjet ankesës së protokolluar me Nr.186 Prot, datë 05.06.2025, në lidhje me mospërbushjen nga ana e z. Çelo Hoxha të kriterit të veçantë të përcaktuar në germën b), së pikës 1 së Nenit 18, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizimit në Shqipëri*", i ndryshuar, janë të pabazuara në ligj dhe vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ISKK-së Nr.5, datë 03.06.2025 dhe rrëzimin e ankimit në fjalë.
2. Ngarkohet Sekretari i Bordit për njoftimin e ankuesit z.Agim Baçi në lidhje me këtë vendimarrje.

KRYETARI

Mentor Beqa



Konc: L.Aliko